



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 17.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, , Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Milva Ekonomi dhe Paulin Sterkaj.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslim Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Luan Harusha, Endrit Braimllari, Xhemal Gjunksi dhe Isuf Çelaj

Të ftuar:

Genti Cakaj - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani - Drejtoreshë e Fondeve IPA

Renata Balliu – Përfaqësuese nga Drejtoria Juridike e Ministrisë së Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, meqenëse kuorumi është i pranishëm. Sot në mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare kemi parashikuar diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi -Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Për të prezantuar këtë projektligj dhe, natyrisht, për të diskutuar me deputetët kemi ftuar zëvendësministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Genti Cakaj, drejtoreshën e fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, zonjën Daniela Çekani dhe drejtoreshë Juridike të Ministrisë së Brendshme, zonjën Renata Balliu. Faleminderit dhe mirë se keni ardhur!

Relatore është deputetja Elona Gjebrea.

Përpara se t'i jap fjalën zonjës Gjebrea, natyrisht edhe juve, dua të them se ne kemi diskutuar jo më larg se ditën e hënë në këtë komision kemi miratuar një marrëveshje të ngjashme me Kosovën. Gjatë diskutimit kuptuam se në vitin 2016, kur janë negociuar marrëveshje të tilla, besoj se në rolin e koordinatorit ka qenë Ministria e Integrimit, nuk është marrë mendimi i Ministrisë së Brendshme, për rrjedhojë këto marrëveshje financiare për bashkëpunimin ndërkufitar nuk kanë në përmbajtje ndërhyrjen në infrastrukturën e pikave të kalimit kufitar, gjë që, në gjykimin e këtij komisioni, duket shumë e rëndësishme për të lehtësuar çdo lloj marrëdhënie tjetër që ne kërkojmë të vendosim në atë anë dhe në këtë anë të kufirit. Sidoqoftë, mbledhja për këto dy projektligje na ka vlejtur ne dhe juve për të kuptuar se në negociime të kësaj natyre është shumë e rëndësishme që ne të dëgjojmë edhe Ministrinë e Brendshme, me qëllim që të mundemi, për aq sa mundet të negociohet edhe me palën tjetër, edhe me Komisionin European, që edhe pikat e kalimit kufitar të jenë pjesë, pra ndërhyrja në infrastrukturën e tyre të jetë pjesë që mund të lehtësohet me investime të tilla.

Gjithashtu, dua të bëj me dije kolegët, që, sipas asaj që kishim fiksuar në mbledhje e shkuar na është në dispozicion nga Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme edhe lista e projekteve fituese për të dyja marrëveshjet e bashkëpunimit financiar për pikat e kalimit kufitar, qoftë ajo që lidhet me Malin e Zi, qoftë ajo që lidhet me Kosovën, po kështu kemi një informacion. Kështu që jeni të lirë që duke u orientuar mbi këto dokumente të shkruara që i keni përpara të ezaurojmë çfarëdolloj pyetjeje.

Fjala është për ju, zoti Cakaj.

Genti Cakaj - Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Për mua është një ndjenjë pozitive e dyfishtë të jem sot këtu para jush, së pari, për shkaqe personale që t'ju njoh të gjithëve, në mënyrë që të krijojmë një raport kolegjal dhe, së dyti, institucionale, në mënyrë që të jem llogaridhënës dhe i përgjegjshëm në raport me ju.

Po ashtu, jam para një situatë problematike, meqenëse kam ardhur të prezantoj dy produkte, të cilat në përgjithësi datojnë para ardhjes sime në Shqipëri dhe në veçanti para angazhimit tim në ministri. Sidoqoftë, për të qenë profesional dhe për të marrë të gjitha përgjegjësitë në raport me detyrën që më të takon, kam ardhur të bëjë prezantimin e dy marrëveshjeve dhe të elaburojmë dy çështjet në fjalë.

Propozimi për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”, është pjesë e kuadrit të bashkëpunimit ndërkufitar, fondeve IPA, 2014-2020.

Po specifikoj tri pika, të cilat janë të rëndësishme për dijeninë tuaj, në rastin e marrëveshjes Shqipëri Mali i Zi dhe Komision Europian.

Së pari, korniza ligjore, marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga ana e Këshillit të Ministrave përmes vendimit nr. 798, datë 29.12.2017. Po ashtu marrëveshja është nënshkruar për palën shqiptare nga ana e ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, Zoti Ditmir Bushati, në datën 29 dhjetor 2017.

Së dyti, dua t'ju tërheq vëmendjen në aspektin financiar të kësaj marrëveshjeje. Programi për bashkëpunimin ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi viti 2014-2020 është miratuar nga komisioni me vendim zbatues me nr. C 9352 në datën 2 dhjetor të vitit 2014. Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumenteve për asistencë financiare paraantarësim, me vlerë të përgjithshme 1 milion e 700 mijë euro për të dyja vendet.

Po ashtu, duke pasur parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të dy vendeve, bashkërisht shuma do të plotësohet prej 300 mijë eurove dhe për pasojë buxheti i këtij projekti do të arrijë vlerën e 2 milionë eurove.

Së fundi, për efektin përmbajtësor të këtij projekti, përfituesit e këtij programi do të jenë në zonat si vijojnë: Mali i Zi, Andreavicës, Beranës, Petnicës, Plavës, Gucisë, Rozhajës, Podgoricës, Cetinjës, Danielogradit, Beogradit, Barit dhe Ulqinit; qarku Shkodër, Bashkia Shkodër, Bashkia e Malësisë së Madhe, Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Pukë dhe Bashkia Vau i Dejës; qarku Lezhë, Bashkia Lezhë, Bashkia Kurbin, Bashkia Mirditë dhe Bashkia Tropojë.

Programi i bashkëpunimit Mali i Zi-Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të dy zonave ndërkufitare, ku projektet do të ndërlidhen me tri shtylla kryesore: nxitja e turizmit, trashëgimia kulturore dhe natyrore; mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes së lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut, si dhe nxitja e punësimit dhe lëvizja gjeografike e punonjësve, përfshirja sociale dhe kulturore përtej kufirit.

Për të mos humbur kohë duke lexuar të gjithë dokumentin, bëra një përmbledhje të shkurtër të materialit që keni përpara dhe, nëse më lejoni, mund të bëj të njëjtën gjë edhe për marrëveshjen me Kosovën.

Ermonela Felaj – Marrëveshjen me Kosovën e kemi diskutuar.

Genti Cakaj – Sipas informacionit që kam, ka pasur edhe një pyetje lidhur me marrëveshjen me Kosovën.

Ermonela Felaj- Pyetja ka qenë për listën e projekteve. Meqenëse në komision doli kjo e dhënë, u kërkua nga anëtarët që të kishim listën e projekteve fituese të IPA1, në mënyrë që të kuptojmë shpërndarjen dhe vlerën që është përfituar nga organizmat konkurrues në këto aplikime.

Genti Cakaj – Së fundi, dua t'ju them se jam në dispozicion të përgjigjeve tuaja dhe sqarimeve shtesë, duke llogaritur edhe asistencën e drejtoreshës, e cila ka qenë e përfshirë në përcaktimin e detajeve teknike të kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit shumë!

Ermonela Felaj – Fjalën e ka relatorja, zonja Elona Gjebrea.

Elona Gjebrea- Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Projektligji që ne sot do të kalojmë në komision ka të bëjë me marrëveshjen e financimit ndërmjet Republikës së Malit të Zi, Këshillit të Ministrave dhe Komisionit European për programin e veprimit ndërkufitar IPA 2 Mali i Zi dhe Shqipëri. Sigurisht që kjo ka të bëjë me alokimet e vitit 2016 dhe, në mënyrë shoqërore, dua t'i them zëvendësministrit që në detyrën tuaj jo domosdoshmërisht keni të bëni me projekte apo me detyrime të periudhës që ju keni ardhur, por mund të keni edhe projekte të viteve të kaluara dhe kjo nuk do të thotë që ju të viheni në vështirësi, pasi presupozohet se Ministria e Punëve të Jashtme ka një staf, i cili ka një memorie institucionale dhe ndihmon në kryerjen e detyrave institucionale që ka kjo ministri dhe, konkretisht, rasti juaj.

Duke kaluar te projektligji, kjo është një vlerë shumë e madhe për Shqipërinë, aq më tepër që ndihmon në fuqizimin e bashkëpunimit ndërkufitar, qoftë në nxitjen e turizmit dhe

trashëgiminë kulturore, qoftë në mbrojtjen e mjedisit dhe në lehtësimin e ndryshimeve klimatike apo nxitjen e punësimit dhe lëvizjen e punonjësve. Kështu, patjetër që kjo është një mënyrë shumë e mirë që Mali i Zi dhe Shqipëria të bashkëpunojnë ngushtë për të koordinuar, për të menaxhuar dhe për të mbikëqyrur këtë program.

Sigurisht që këtu ka një strukturë të dedikuar. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Europës, si koordinatori kombëtar, patjetër që do të luajë rolin kryesor në lidhje me këtë. Kështu që mendoj se kjo është një vlerë e shtuar që BE-ja jep për të nxitur bashkëpunimin ndërkuftar. Kjo vlerë e konsiderueshme ka të bëjë edhe me alokimet e mëtejshme, të cilat do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare midis vendit tonë, Malit të Zi dhe Komisionit Europian. Kështu që ju përgëzoj që keni arritur ta përmbushni këtë program të rëndësishëm, i cili prek Malin e Zi dhe Shqipërinë. Në këtë rast, kemi Shkodrën, Lezhën dhe Tropojën. Besoj se edhe Pjerini do të flasë për këtë.

Kam një sugjerim për sa i përket pjesës së projekteve dhe rezultateve të pritshme. Është shumë mirë që e kemi këtë, dhe faleminderit që na e vini në dispozicion, sepse kuptojmë më shumë dhe më konkretisht se çfarë ndodh dhe për çfarë konkretisht kanë të bëjnë këto projekte. Për rezultatet e pritshme diku flitet me indikatorë të matshëm, diku tjetër pak të përgjithshëm dhe kjo, në fakt, e bën pak të vështirë për të kuptuar realisht se çfarë do të dalë nga ky projekt. Kështu që mendoj se ka nevojë që ndoshta personat përgjegjës, që do të punojnë në projekt, të jenë më të fokusuar te rezultatet e matshme dhe jo në një sipërmarrje dixhitale, pa dhënë detaje ose në mënyrë konkrete diku tjetër të jetë një nxitje e bashkëpunimit dhe asgjë më shumë. Për shembull, këtu flitet për 60 përfitues të integruar ekonomikisht, të cilët janë vërtet indikatorë të matshëm që tregojnë se çfarë do të arrihet nëpërmjet këtij projekti për një pikë të caktuar, se këtu flasim për shumë pika. Sigurisht edhe lidhja e bizneseve me bujqësinë. Mendoj se puna duhet të fokusohet tek të rinjtë. Kemi nevojë që të rinjtë të nxiten qoftë edhe me mënyrat inovative të nxitjes së biznesit të vogël. Ne duam që të rinjtë të kontribuojnë për vendin tonë. Kështu që edhe kjo është një mënyrë e mirë për të fuqizuar qoftë në Shqipëri, qoftë edhe te fqinjët tanë.

Ju falënderoj dhe ju uroj suksese!

Ermonela Felaj – Ju falënderoj, kolege!

Fjala është për anëtarët e komisionit, në rast se kanë pyetje.

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Ju faleminderit, zonja kryetare!

Kjo është një pyetje jashtë sferës që mbulojmë ne, sepse ne nuk jemi ekonomistë dhe nuk jemi as te Komisioni i Ekonomisë, por ndoshta përbën interes edhe për opinionin publik.

Alokimet për vitin 2016 “IPA 2” kapin një vlerë relativisht 1 milionë e 700 mijë euro. Jam i interesuar të di në këtë vlerën 1 milion e 700 mijë euro sa i kalojnë Shqipërisë dhe sa i kalojnë Malit të Zi.

E dyta, këtu thuhet se i gjithë projekti përfshin rreth 11 mijë e 970 kilometra katrorë me një popullsi prej 749 mijë e 527. Sa territor të Republikës së Shqipërisë mbulon dhe sa të Malit të Zi, respektivisht edhe në popullsi?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Besoj se pyetja e kolegut është e qartë.

Kush do të përgjigjet?

Po, zonja Çekani.

Daniela Çekani – Faleminderit!

Lidhur me pyetjen e parë për alokimet financiare të vitit 2016 të vlerës 1 milion e 700 mijë euro, më duhet të sqaroj që, kur hapet një thirrje për projektpropozime, sigurisht që i përfshin të dyja vendet, sepse për të gjitha projektet, të cilat aplikohen nga të gjitha palët e interesuara ku janë qoftë institucionet shtetërore, ose organizatat jofitimprurëse, universitetet etj., bashkëpunohet në partnershipe. Minimumi i partneritetit është 1 aplikant nga pala shqiptare dhe një aplikant nga pala malazeze, por jo detyrimisht ky numër mund të mbetet 2 si partneritet, por mund të jetë edhe më shumë se kaq. Se sa mund të përfitojë pala shqiptare apo ajo malazeze, kjo nuk mund të vlerësohet në këtë moment, por pasi përzgjidhen projektet ftuese. Kjo ka të bëjë me nivelin e absorbimit, sepse edhe vetë projekti fitues mund të ketë në një rast një përfitues shqiptar me një buxhet të konsiderueshëm ose jo dhe përsëri nga buxheti që përthithet varet se sa absorbohet deri në fund dhe si realizohen aktivitetet. Pra, ne nuk mund ta themi në këtë moment se sa do të përthithet nga pala shqiptare apo nga pala malazeze.

Alokimet janë në total dhe më pas vlerësohet impakti dhe përthithja pas implementimit në një periudhë që mund të jetë 1 muaj deri në 3 vjet, në varësi të aplikimit që është bërë, për të cilën ne, si ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, nuk jemi përgjegjës për këtë. Ne jemi përgjegjës për kriteret e thirrjes, për draftimin e të gjitha teknikaliteteve të tjera, por është përgjegjëse ministria përkatëse apo institucionet përkatëse, në varësi të prioritetit për të cilin ata kanë aplikuar.

Unë dua të përfitoj nga rasti për të bërë një sqarim lidhur me koordinimin e prioriteteve në momentin e programimit të programit. Të gjitha prioritetet nga ministritë vijnë në tavolinë për t’u negociuar bashkë me Bashkimin European dhe me palën pjesëmarrëse, Malin e Zi në këtë rast, por i nënshtrohet një ushtrimi seleksionues prioritizim mbi prioritizim, duke u bazuar në dokumente strategjike. Kjo është arsyeja pse rikonstruksioni i pikave kufitare nuk është

vlerësuar me interes të përbashkët nga të dyja palët dhe ndoshta nuk ka qenë brenda kornizës në momentin që është negociuar, flasim për vitin 2013. Duke qenë se pikat ndërkufitare përbëjnë në vetvete nevojën për financime infrastrukturore, këto tip programesh lidhen më tepër me atë që quhet *soft infrastructure* dhe nuk kanë alokime të mirëfillta për investime të mirëfillta infrastrukturore. Unë gjej rastin të përmend, meqenëse jemi në Komisionin e Sigurisë, që financimet nga fondet IPA është bërë nëpërmjet programit kombëtar dhe është rikonstruktuar, për shembull, pika kufitare e Hanit të Hotit, por jo nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar. Këtu kemi pasur më tepër investime të një natyre tjetër, që nga rritja e kapaciteteve, promovim pikash kulturore, pra në varësi të prioriteteve që ka programi. Kjo ishte përgjigjja ime për pyetjen e parë.

Pyetja e dytë e zotërisë...

Genti Cakaj - A mund të bëj një sqarim shtesë, nëse është e nevojshme?

Lidhur me hapësirën territoriale që mbulon fondi, ajo është 11,970 metra katrorë, dhe është shuma e të gjitha njësive territoriale të përmendura, të cilat do të afektohen prej këtyre projekteve. Popullsia përftuese është 749,257 banorë, që po ashtu është numri i regjistruar i banorëve në komunat ose hapësirat territoriale, të cilat do të jenë përfituese të fondeve. Ky është sqarimi në terma numerikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë i numërova që prej Malit të Zi në faqen 2...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë tregova se si janë matur. Pra, në mënyrë mekanike janë bashkuar dhe është matur numri i popullsisë përfituese.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Ju lutem, që të mos krijojmë konfuzion!

Pyetja ishte shumë e qartë: sa është përfitimi në shifrat e popullsisë dhe në sipërfaqe për Malin e Zi dhe sa është përfitimi për Shqipërinë? Nëse e keni këtë shifër, na e thoni.

Genti Cakaj - Dua të them edhe diçka dhe më pas po i jap fjalën drejtoreshës për sqarime shtesë.

Së dyti, benefitet prej projekteve, natyrisht, varen nga cilësia e propozimeve dhe miratimi.

Ermonela Felaj – Kjo është tjetër gjë, ne po flasim për momentin e negocimit. Pra, që në negocim të hyjnë projekte që i vlejnë një sipërfaqeje sa më të madhe dhe sa më të populluar. Ne e kemi sqaruar që nuk është ministria juaj institucioni që përgjigjet për prokurimin dhe përzgjedhjen e aplikantëve, por është delegacioni i Bashkimit European. Ne

kemi kuptuar se ju vetëm fasilitoni procesin e pjesëmarrjes së aplikantëve në prokurimet e kësaj natyre.

Fjalën e ka zonja Çekani.

Daniela Çekani – Gjithmonë gjatë negocimit të territoreve, duke qenë se janë bashkëpunime ndërkufitare, zonat duhet të ndërveprojnë dhe të kenë akses me njëra-tjetrën, prandaj janë përzgjedhur nga pala shqiptare dhe malazeze zonat në fjalë. Ne ruajmë një balancë, pra mund të ketë 49 me 51% nga pikëpamja e sipërfaqes së territoreve, të dhëna më të sakta dhe më në detaje lidhur me numrin e popullsisë. Ne mund t’ju ofrojmë, por nuk i kemi marrë, sepse koordinojmë 8 programe të ndryshme dhe është e vështirë të memorizohen, por ruhet një balancë e caktuar 48 me 52% dhe 49 me 51%, sepse gjithmonë mund të ketë devianca që nuk vijnë nga faktorë koordinues, por lidhen me faktorë të tjerë. Për interesin tuaj ne mund t’jua vëmë në dispozicion menjëherë këto të dhëna, sapo të mbarojë kjo seancë, në terma konkretë.

Ermonela Felaj – Jo, e kemi të dhënë.

Daniela Çekani – Është e dhënë, por mund ta japim edhe më të detajuar, me numër popullsie dhe numra konkretë, por nuk ka devianca apo mungesë balance në përcaktimin e tyre. Ne ndjekim të njëjtën qasje që ndjek edhe Bashkimi Europian, pra jo domosdoshmërisht është në vlerësimin tonë.

Ermonela Felaj – Është e qartë.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Më tepër e kisha te serioziteti i palës shqiptare që merret me përgatitjen e këtyre projekteve. Kjo nuk është ndonjë pyetje që ju duhet të merrni kohë për të na sqaruar, sepse dihet se sa është popullsia e Shkodrës, e Lezhës dhe e Tropojës, por e kam te serioziteti, sepse e njëjta gjë u vë re edhe te drafti që kaluam me Kosovën, ku ju patët vërejtje edhe për këtë pjesë, apo jo. Prandaj nuk keni përse ta anashkaloni këtë dhe të thoni që janë parime dhe standarde. Unë e di pjesën teorike dhe ju e dini më mirë, sepse jeni e profilit, por mua më intereson drejtpërdrejt nëse këtu janë përmendur 12 apo 13 njësi dhe komuna, të cilat kanë popullsi dhe sipërfaqe të vogla, unë jam i interesuar për palën shqiptare, sepse jam deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe, kur ta miratoj, dua ta di se sa banorë përfitojnë nga ky implementim.

Daniela Çekani – E kuptoj shqetësimin tuaj, por mund t’ju garantoj që për sa i përket përzgjedhjes së këtyre zonave, ndonjëherë në numër duket sikur janë më pak nga ana shqiptare, por kjo nuk ka lidhje me këtë, por me organizimin. Diku referohen si komuna, diku si qarqe

dhe diku si bashki, kjo bën që në dukje numerike të ketë ndryshime, por në terma përqindje të popullsisë ruhet balanca.

Gjatë programimit të programit janë angazhuar ekspertë të Komisionit Europian, të cilët janë ekspertë në fushën e studimeve të mirëfillta për të përcaktuar cilat janë nevojat e zonave të përfshira. Kjo bëhet mbi bazë metodash, që janë profesionalisht të miratuara dhe që shërbejnë për identifikimin real të nevojave. Pra, nuk është thjesht bazuar në nevoja të shprehura në mënyrë verbale të negociuara. E gjithë ekspertiza e Bashkimit Europian ofrohet për të gjitha vendet e rajonit në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën procedurë.

Ne jemi njohur me të dhënat, kemi negociuar në tavolinat dhe takimet e përbashkëta, gjithmonë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkimit Europian që të jemi në përputhje me nevojat përkundrejt dokumenteve strategjik që ne disponojmë në këtë fushë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Por pyetja nuk ishte kaq e vështirë sa për t'u humbur në shpjegime të tëra. Ju jeni këtu si përfaqësuese e institucioneve shqiptare dhe, kur flasim për një gjë që përfiton Shqipëria, shifrat dhe të gjitha dhënat duhet të dihen përmendësh. Nuk mund të thoni: do të vijmë në mbledhjen tjetër ose do të sjellim një material tjetër. Ne jemi mbledhur sot për këtë gjë. Kjo është shumë e thjeshtë, sepse e keni edhe në program ku thuhet: programi mbulon një territor prej 11970 kilometrash katrorë. Territori në Mal të Zi ka 52,1% të sipërfaqes së programit, ndërsa pjesa e ngelur është e Shqipërisë. Kaq. Ne nuk po ju pyesim sa përfiton Mali i Zi, sepse kjo është pjesë e informacionit të përgjithshëm, por të dhënat që i takojnë Shqipërisë duhen ndarë me një gjuhë të thjeshtë, konkrete dhe të saktë, në mënyrë që të mos kuptojmë vetëm ne. Këto seanca nuk na shërbejnë vetë neve, por të gjithë publikut që na ndjek, veçanërisht njerëzve që jetojnë në ato zona dhe që janë përfitues të këtij programi. A ka mundësi që ne kur të vijmë në Kuvendin e Shqipërisë ta zhveshim gjuhën teknike dhe të jemi sa më konkretë që të përcjellim një mesazh të qartë te njerëzit. Besoj se kjo nuk është e pamundur, sepse edhe ju në fund të ditës jeni qytetarë të këtij vendi dhe natyrisht nuk i shpëtoni dot vështrimit të gjërave në këtë mënyrë siç po mundemi t'i ndajmë ne sot.

Vazhdojmë me pyetjet.

Genti Cakaj - Vërejtja është krejtësisht legjitime.

Ermonela Felaj - Ju lutem, nuk e kishim këtë gjë për debat!

Fjalën e ka zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj - Mbështes fjalën e kolegut parafolës për punën e fondeve, sepse aty thuhet se ky program do të zbatohet në menaxhim indirekt nga Mali i Zi dhe autoritetet kontraktuese, është Drejtoria e Financave të administrimit të fondeve ndihmëse të BE-së. Të

gjitha projektet tona menaxhohen nga të huajt dhe ne nuk po menaxhojmë asgjë si shqiptarë. Kam disa pyetje. Shikoj te lista e projekteve fituese, ku thoni: “Rezultati i pritshëm”, dua një informacion, si i matni ju rezultatet pas projektit? A keni ndonjë eksperiencë se si i keni matur këto rezultate?

Në marrëveshjen financiare, te kushtet e veçanta, pika 4 e saj thuhet se pika e kontaktit të përfaqësuesit IPA 2 që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërsëdrejti me Zyrën Europiane kundër Mashtrimit. Është e vërtetë kjo? Ka Zyrë Europiane kundër Mashtrimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Daniela Çekani - Po e filloj nga kjo e fundit. E kam pak të vështirë t’i shkëputem teknikaliteteve për pyetje të tilla, sepse kjo ka të bëjë me arkitekturën institucionale të BE-së. Në këtë rast bashkëpunimi vjen kur ka problematika jo vetëm me mosfunksionimin efektiv të sistemeve të brendshme të kontrollit në shtetin përkatës, por janë evidentuar problematika në keqmenaxhimin e fondeve. Në këtë rast, në momentin që na bëjnë me dije, ne jemi të detyruar të raportojmë. Këto janë modalitete që ne i ndjekim për çdo program dhe kemi pika të caktuara kontakti brenda drejtorisë që përfaqësoj, që kanë detyra të caktuara në përputhje me detyrimet që kemi në kuadër të marrëveshjes. Kjo zyrë kështu quhet, shqip Zyra kundër Mashtrimit, por funksionon e tillë për të gjithë rajonit dhe kemi të njëjtat detyra në rastin e identifikimit.

Por siç e thashë rezultatet e dukshme dhe indikatorët nuk përcaktohen nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, për projektet që implementohen janë partneritetet, partnerët lider dhe institucionet kryesore përgjegjëse që kanë shkruar projektin dhe janë zgjedhur fitues.

Vullnet Sinaj - A ka raste të tilla mashtrimi!

Daniela Çekani – Deri tani nuk rezultojnë të tilla. Ka lidhje me funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit brenda të gjithë arkitekturës institucionale. Këto janë teknike.

Genti Cakaj - Meqenëse u ngrit nga dy parafolësit për rezultatet, e para ministria jonë nuk është përcaktuese ultimative e indikatorëve të rezultateve të projekteve meqenëse kjo u takon aplikuesve dhe pastaj komisionit të vlerësimit për rezultatet e prekshme. Sidoqoftë për të kursyer diskutimet e gjata, unë do t’ju dorëzoj tërësinë e projekteve të programit paraprak, ku është e përcaktuar edhe forma në mënyrë konkrete sesi janë marrë rezultatet e programeve të caktuara. Pra, për sa i përket bashkëpunimit Shqipëri- Mali i Zi, matja e performancës dhe përcaktimi i indikatorëve ka qenë si në dokumentin që do t’ju dorëzoj tani.

Ermonela Felaj - Në fakt, e kemi atë.

Daniela Çekani- Ne këto të dhëna i nxjerrim nga *database*-i, sepse vetë nuk jemi pjesë e përzgjedhjes së tyre. Ne i referohemi siç i kanë shkruar ata për të qenë korrektë dhe transparentë me mënyrën sesi ata kanë aplikuar dhe cilët janë partnerët.

Ermonela Felaj - Po, është e qartë.

A mund të vijojmë me një pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ekonomi, kishit diçka?

Milva Ekonomi – Kjo është thirrja e parë brenda këtij programi, apo e dyta?

Daniela Çekani - Thirrja e parë përfshin alokimet e vitit 2014-2015 për të cilën ju dispononi informacionet dhe tabelën e projekteve. Thirrja e dytë nuk është hapur ende, pritet në fund të këtij viti dhe do të jenë këto alokime, që do të ratifikohen nga parlamenti këtë të enjte, objekt financimi.

Milva Ekonomi – Dua ta vazhdoj pyetjen pas sqarimit. Ky *rate* i suksesit, për të cilin po flasim deri tani, u është komunikuar bashkive tona? U është çuar bashkive tona *rate* i suksesit për OJQ-të apo institucionet që kanë aplikuar? Ua keni bërë me dije këtë?

Daniela Çekani – Ju nënkuptoni që t’u bëhet e ditur se janë fitues të projekteve?

Milva Ekonomi – Po.

Daniela Çekani – Janë struktura të tjera, sekretariate të përbashkëta teknike, për secilin program, të cilat angazhohen për informimin dhe komunikimet me përfituesit, në rastin e shpalljes së rezultateve. Sigurisht, ne facilitojmë gjithmonë, për çdo nevojë, edhe nëpërmjet takimeve, ditëve të informimit, në lidhje me rëndësinë, mënyrën si aplikohet, çfarë metodologjie përdoret, e mbi të gjitha informojmë për mënyrën se si të implementohen fondet në mënyrë korrekte, që të mos arrijmë rezultate të padëshiruara për mosnjohje ligjshmërie, shpenzimesh të kryera nga përfituesit.

Milva Ekonomi – Më falni, edhe një pyetje. Ndërkohë, a keni një tabelë për llojet e tjera të projekteve – jo të IPA-s, sepse ka edhe tituj të tjerë projektesh – që aplikohen për bashki të ndryshme në vend?

Daniela Çekani – Në kuadër të tetë programeve, ne i disponojmë me kërkesën që bëjmë ndaj sekretariateve teknike, të cilat organizojnë në mënyrë më të detajuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. janë struktura të ngritura nga programet, me përfaqësues të dy vendeve, të cilat janë përgjegjëse për informimin.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, ne nuk e dimë asnjëherë se sa përfitime ka një bashki e caktuar, nga tërësia e projekteve në ministrinë tuaj. A dihet kjo?

Daniela Çekani – Vlerësimi i impaktit bëhet gjithmonë pas përfundimit të gjithë perspektivës financiare. Pra, në qoftë se këtë radhë programi është 2014-2020, presupozohet e në vitin 2022 – 2023 të jetë vetë Komisioni European ai që duhet të bëjë vlerësim impakti me ekspertizë të mirëfilltë, sepse vlerësimi i impaktit bëhet njëkohësisht për të dyja vendet. Ne nuk e ndajmë dot apriori se sa shkon për Shqipërinë që në këtë moment, pa përfunduar projektet, pa e parë nëse vetë përfituesit i kanë arritur indikatorët e tyre apo jo, pa dalë në rezultate konkrete. Kohëzgjatja mund të jetë e ndryshme. Ato sapo kanë filluar, dhe ne nuk e masim dot në këtë moment.

Milva Ekonomi – në fakt, unë nuk po ju pyes fare për këtë gjë, por nuk ka rëndësi. Faleminderit për sqarimin! Po ju pyes: në qoftë se unë kam një bashki të caktuar, Shkodrën, e cila ka aplikuar në disa projekte: Interreg, IPA e çfarë mund të ketë tjetër. A e keni ju informacionin se sa projekte janë të lidhura me bashkinë e Shkodrës, ju si Ministri e Punëve të Jashtme?

Daniela Çekani – Jo domosdoshmërisht. Për ato që u referohen programeve që ne koordinojmë po. Sepse mund të jenë edhe me donatorë të tjerë.

Ermonela Felaj – Unë do të rri prapë te pyetja që bëri kolegja Ekonomi. Tani, përgjegjësia e negocimit, sipas asaj që unë mendoj, nuk është e parëndësishme. Është shumë e rëndësishme, pavarësisht se të hollat, investimet, si vlerë, në pjesën e tyre më të madhe vijnë nga Komisioni European. Shqipëria apo çdo vend tjetër fqinj, janë kontributorë më të vegjël.

Në këtë rast unë desha të dija: ju, si negocioni? Sepse keni marrë përsipër përgjegjësinë e negocimit. Mbi çfarë baze e bëni negocimin? Çfarë të dhënash merrni ju? Kë pyesni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. ta dimë.

Daniela Çekani – Është shumë e drejtë. Fillimisht, do të doja të sqaroja se procesi i negocimit të prioriteteve ka ndodhur në vitin 2013 – 2014, në mos gaboj. Pra shumë vite më parë. Tani jemi në periudhën e implementimit të programit.

Siç e përmenda edhe më parë, vlen të thuhet e ka një ekspertizë nga Bashkimi European, e cila bën një vlerësim nevojash mbi bazën e metodologjive përkatëse. Ndërkohë, ministria, e cila ka si rol kryesor koordinimin kombëtar në nivel programi, jo projektsh, e theksoj, mbledh prioritetet e ministrive të linjës, të cilat i krahason apo i gjykon në varësi të dokumenteve strategjike kombëtare, që ne disponojmë, pra janë në linjë apo jo.

Këto prioritete, të cilat mund të jenë, për shembull, dhjetë nga pala shqiptare, dhjetë nga pala malazeze, në një tavolinë të përbashkët, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komisionit European dhe Delegacionit European në Tiranë, vlerësohen në varësi të periudhës kur negociohen. Sepse ne e shikojmë se ka një rregull, që do të thotë se miratojmë alokimet e vitit 2016, dhe këto kontrahohen deri në vitin 2019.

Pra, të gjitha palët janë në tavolinë, dhe procesi i konsultimit ndodh jo vetëm me ministrinë në nivelin e institucioneve qendrore, por edhe në nivelin lokal, nëpërmjet seancave të konsultimit dhe pyetësorëve që bëhen në këtë rast.

Pra, ka një proces seleksionimi prioritetesh, derisa rezultojnë në tre, që është numri maksimal i prioriteteve që një program mund të ketë, sipas rregullave të BE-së.

Ermonela Felaj – Na e sqaroni pak këtë nivelin lokal, ju lutem! Çfarë keni parasysh kur thoni se do të konsultoheni edhe në nivel lokal? Vetë ju me bashkitë, apo u kërkonit institucioneve të tjera të konsultohen ato me bashkitë dhe mandej ju të merrni produktin?

Daniela Çekani – Jo, ne i kemi përfshirë në mënyrë direkte.

Ermonela Felaj – Ju u bëni konsultime direkte? Në rastin e negocimit që është bërë në vitin 2013-2014, ne e patëm këtu edhe zëvendësministren e Brendshme, dhe na tha se nuk është pyetur Ministria e Brendshme.

Daniela Çekani - Unë kam përshtypjen se kjo u referohet problematikave për faktin nëse kemi qenë pjesë e procesit apo jo. Për shembull, sot mund të mos isha unë këtu për një arsye apo për një tjetër, por duhej të ishte një drejtoreshë e re, e cila nuk e ka informacionin se çfarë ka ndodhur në vitin 2013-2014, kështu që gjithmonë ka pasur prioritete, të cilat janë negociuar me ministrinë, sepse ne si ministri këtë rol kemi, koordinimin, dhe sigurisht që nuk mund ta bëjmë koordinimin pa i ftuar institucionet, pa marrë nga ata prioritetet dhe për këtë ne kemi edhe të dhëna të tjera, por duhet t'i referohemi arkivit pastaj dhe proceseve. Sigurisht që bëhet në këtë mënyrë dhe nuk është hera e parë, se të njëjtit ushtrim i jemi nënshtruar edhe gjatë perspektives financiare 2007-2013.

Ermonela Felaj – Dakord. Nuk po zgjatem, por mënyrë për ta verifikuar këtë gjë ka, megjithatë unë marr shkas nga mbledhja e ditës së hënë, ku ju personalisht thatë se ne jemi në prag të negocimit të IPA3 dhe do ta bëjmë këtë diskutim edhe me Ministrinë e Brendshme për të kuptuar se cilat janë nevojat e saj, por ndërkohë ne nuk mundemi të bëhemi kaq nihilistë dhe të themi se jo, nuk ka rëndësi ndërhyrja në infrastrukturën e pikave të kalimit kufitar. Aty jepet shërbimi i parë, aty është impakt i parë. Për çfarë lloj turizmi, për çfarë lloj shkëmbimi kulturor bëjmë fjalë ne, kur pikat e kalimit kufitar kanë problemet e tyre?

Si mund të pretendojmë ne se do të rrisim shkëmbimet ndërmjet dy vendeve në rast se shërbimi i pengon njerëzit që të afrohem me njëri-tjetrin? Prandaj ishte ndërhyrja jonë. Unë shoh, për shembull, se nuk është se ka qenë edhe aq pa vëmendje historia e marrjes së nevojave që dikur vareshin nga Ministria e Brendshme dhe sot i ka Ministria e Mbrojtjes. Shoh, për shembull, që për fatkeqësitë natyrore ka pasur projekt dhe është fituar nga prefektura e Shkodrës, sikurse ka fituar edhe Mali i Zi. Kjo ka qenë nevojë deri para fillimit të mandatit të dytë dhe e ka ndjekur Ministria e Brendshme, sepse struktura e emergjencës civile, ju e dini shumë mirë, varej nga kjo ministri. Ndërkohë ka ndodhur kalimi te Ministria e Mbrojtjes. Pra dua të them që, në rast se ju do të uleni dhe do t'i diskutoni seriozisht nevojat, nuk ka asnjë arsye që në diskutimin fundor me palën që keni përballë, me Komisionin European, kjo të mos jetë një nevojë prioritare, nevojat që lidhen me pikën e kalimit kufitar.

Nuk po flasim që ju t'i përmbysni pikat e kalimit kufitar dhe t'i bëni nga e para, por projekte të tilla mund të shërbejnë, fjala vjen, që një strehëz, ku njerëzit kanë nevojë të rrinë gjatë kohës që bëhet kontrolli i mjeteve me të cilat udhëtojnë apo i bagazheve të tyre, mund të suportohet, se nuk është në ato nivele që diskutuam deri tani. Të tilla nevoja pikat e kalimit kufitar kanë shumë.

Ne e kthyem vëmendjen te këto dy marrëveshje jo më kot, por për faktin e thjeshtë se ky komision ka ndërmarrë një kalendar pune për monitorimin e të gjitha pikave të kalimit kufitar në vend dhe fakti që ne kemi shkuar atje, fakti që ne kemi biseduar me drejtuesit e këtyre stacioneve dhe kemi konstatuar vetë gjendjen në vend, na bën të jemi kaq aktivë në këtë diskutim dhe natyrisht nuk do ta linim pa shfrytëzuar këtë rast, qoftë për të kuptuar çfarë është bërë, si funksionon e të gjitha me radhë, por edhe për të nxitur institucionin që ju përfaqësoni, Ministrinë e Brendshme, por edhe çdo institucion tjetër qoftë ky qendror apo lokal, që në mundësinë më të parë të mund të shfrytëzojë programe të tilla. Natyrisht ato u japin shumë vlerë dhe vlerat, sado modeste qofshin, por modeste nuk janë hiç, se po të shohësh listën e projekteve fituese që ju na keni vënë në dispozicion janë, të paktën, 470 588 euro që janë përfituar, kur bëhet fjalë për bashkëpunimin Shqipëri- Kosovë dhe buxhetin total kur bëhet fjalë për bashkëpunimin Shqipëri – Kosovë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po e them në euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Buxheti total në rastin tjetër, Shqipëri – Mali i Zi...

Danjela Çekani – Janë disa partnerë të përfshirë dhe buxhetet ndahen.

Ermonela Felaj – Atë po them.

Danjela Çekani – Sigurisht, janë shumë...

Ermonela Felaj – Përfitimet nuk janë të vogla, janë të mëdha, ndaj le të bëjmë pjesë gjërat që janë të dukshme. Prandaj edhe investimi nuk shkon në vetvete.

Danjela Çekani – Unë prandaj e përmenda, jo se nuk janë të rëndësishme, përkundrazi, janë tejet të rëndësishme, por janë gjetur në varësi të shumës së alokimit që duhen. Pra, gjenden modalitete të tjera financiare. Prandaj thashë që nëpërmjet programit kombëtar IPA jondërkufitar është financuar, për shembull, pika kufitare e Hanit të Hotit, sepse është vlerësuar që duhet një portofol financiar më i madh, që nuk mund të adresohet nëpërmjet këtyre programeve. Madje në këto programe përgjithësisht adresohen problematika që lidhen me promovime, jo domosdoshmërisht komponenti infrastrukturor në vetvete, sepse janë portofole të vogla, por, sigurisht, Ministria e Brendshme ka përcjellë prioritetet e saj dhe kanë qenë pjesë e diskutimeve në atë kohë, që, siç e thashë, ka edhe një proces seleksionimi prioritetesh në nivel programi, që përfshin të dyja shtetet. Pra, nuk ka lidhje me rëndësinë që ne i kushtojmë, pasi ne i kushtojmë rëndësi të barabartë gjithsecilës prej ministreve dhe prioritetëve që ato mbulojnë.

Më pas bëhet ky lloj seleksionimi që, sigurisht, është edhe në një qasje të BE-së, në përputhje me çdo gjë që quhet dokument strategjik kombëtar dhe të BE-së në kuptimin më të gjerë të fjalës, por sigurisht që ne jemi të monitoruar dhe procesi bëhet përgjatë gjithë kohës transparent. Ne e kemi detyrim për të shprehur çdo fazë të programit qoftë në *web-e*, qoftë nëpërmjet informacioneve të ndryshme.

Janë procese që zgjasin shumë në kohë dhe përmbajnë në vetvete shumë faza negociimi.

Ermonela Felaj – Pikërisht për këtë, pra. Koha e gjatë që marrin këto projekte nuk duhet të shërbejë si një gjë për ta nënvlerësuar. Negocimi është shumë i rëndësishëm, ndaj bëjeni atë me mendje dhe me zemër për interesat që kemi ne, si vend, si shqiptarë. Tjetër gjë pastaj se sa do të mbërrini deri në fund, por merrini parasysh të gjitha nevojat, pasi ne këtu e patëm Ministrinë e Brendshme, e cila na tha se nuk janë pyetur.

Në fakt, nuk e besojmë të jetë ngritur ky problem më parë, sepse marrëveshje të tilla nuk kanë kaluar në parlament ose të paktën në Komisionin e Sigurisë marrëveshje të kësaj natyre nuk kanë kaluar.

Danjela Çekani – Është e vërtetë se nuk kanë kaluar.

Ermonela Felaj – Ne i kemi kërkuar vetë këto marrëveshje dhe vetëm për ta kthyer vëmendjen në këtë pikë. Pra, ne po kërkojmë që ta bëni ju, nuk negociojmë ne, por ne ju nxisim që ju ta negocioni, ta hidhni në diskutim këtë gjë konkretisht, t'ua shpjegoni njerëzve pse është

e nevojshme kjo gjë, e cila është tejet e nevojshme. Nuk besoj se ka ndonjë nga pala tjetër që të thotë...

Danjela Çekani – Është e padiskutueshme.

Ermonela Felaj – ...se nuk na duhet. Në fakt, na duhet me patjetër.

Ju flisni për Hanin e Hotit, por nuk është vetëm Hani i Hotit në Shqipëri.

Danjela Çekani – Absolutisht jo, por çdo program ka një...

Ermonela Felaj – Madje për nga rëndësia dhe pesha mund të ishte i fundit.

Danjela Çekani – ...portofol të caktuar financiar dhe në qoftë se vlerësohet që nuk mjafton...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Jo, i fundit në kuptimin e pikëpamjes që sa udhëtarë kalojnë dhe sa e ardhur nga tarifa realizohet. Nuk e kam për këtë pjesë.

Paulin Sterkaj – Më vjen keq, sepse Hani i Hotit është porta tokësore drejt Perëndimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po më pëlqen, sepse atë zonë e përfaqësoj unë.

Që të keni njëfarë njohjeje për sa u përket projekteve IPA, këto shkojnë më tepër në nivelin e specializimit të grupeve të interesit dhe të njerëzve që do të merren me projektin, sesa investime në objekt.

Po t'i marrësh në analizë të gjitha këto, kështu shkojnë investimet: marrin disa që drejtojnë projektet, marrin disa që ndjekin, bëjnë studime e të tjerë. Nuk është se ka financa që kjo të mbështetet për t'u bërë investime konkrete të prekshme, por më tepër mbështet investimet të burimet njerëzore për të ndërtuar marrëdhënie korrekte ndërkufitare me komshinjtë tanë të Malit të Zi ose me vëllezërit tanë kosovarë.

Megjithatë, Hani i Hotit është e rëndësishme si pikë kalimi kontrolli. Të lidh me Europën, ndërsa këto pikat nga Jugu të lidhin me Detin Mesdhe.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Hani i Hotit ishte edhe prova që projekte të tilla mund të shërbejnë edhe në pikën për të cilën ne po diskutojmë. Prandaj le ta shfrytëzojmë, ta replikojmë shembullin e Hanit të Hotit edhe në mundësi të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se nga kolegët nuk ka pyetje të tjera...

Sadi Vorpsi – Kam edhe unë një pyetje.

Ermonela Felaj – Atëherë, fjala është për ju, zoti Vorpsi, për t’ia kaluar më pas zotit Sinaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, ne e kërkuam tabelën e të gjitha projekteve të IPA-s dhe na vjen mirë që na i sollët sot, në mënyrë që të jemi të qartë edhe ne se do ta votojmë në parlament. Në fakt, unë i hodha një sy dhe meqenëse e njoh prefekturën, sepse *lead partner* besoj se është edhe prefektura e Shkodrës, ligji përcakton se “Prefekti është institucioni që koordinon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor me pushtetin lokal” dhe sot struktura e çdo prefekturë ka një zyrë që quhet Zyra e Emergjencave Civile, e cila është një plus dy.

Lexoj këtu për rezultatet e pritshme, përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të institucioneve që merren me shpëtimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore në zonën e Shkodrës dhe se deri në vitin 2016 institucioni i prefektit ka përfshirë edhe shërbimin e zjarrfikëseve, që me reformën administrativo-territoriale ua kaluam bashkive me të gjitha kapacitetet. Për shkak se koordinon dhe është përfaqësues i qeverisë, unë jam dakord dhe është gjë e mirë, që është marrë në konsideratë që të jetë prefektura.

Pyetja ime konsiston në atë, që prefekti nuk ka kapacitete teknike. Ato i kanë të gjitha bashkitë, duke filluar nga Shërbimi Zjarrfikës, Emergjenca Civile dhe vullnetarët e emergjencave civile.

Cilat janë bashkitë, që përfitojnë nga këto 483 mijë euro?

Danjela Cekani – Unë e kuptoj pyetjen tuaj, por e përmenda edhe pak më parë, se Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme nuk merret me aplikimet e aplikantëve të mundshëm. Ne nuk kemi fare lidhje me ta. Ne nuk paracaktojmë, nëse do të jetë bashkia apo prefektura. Secili është i hapur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është vullneti i lirë, që të aplikojë kushdo. Ne, si ministri kemi përcaktuar se cilët janë partnerët e mundshëm apo aktorët e ligjshëm për të aplikuar. Këta janë bashkia, prefektura dhe vullneti i tyre i lirë bën të mundur të ndërtojnë partneritete me pjesën tjetër, që është pala malazeze dhe ata aplikojnë të lirë. Ne nuk kemi ndikim në këtë proces dhe nuk na lejohet të kemi. Absolutisht, jo. E thashë pak më parë se ne koordinojmë programin në nivel kombëtar, jo projektet. Përgjegjës për zbatimin e këtyre projekteve, që ju keni sot janë vetë ata, që janë *lead*, pra janë partnerët kryesorë të partneriteteve, që ju shihni. Pra, ata janë 4 (dy nga Shqipëria dhe dy nga Mali i Zi). Ata e zgjidhin vetë këtë marrëdhënie, se kush e drejton projektin dhe si do të performojë. Domethënë, kjo nuk lidhet me tagrin e Ministrisë për Europën

dhe Punët e Jashtme. Ne koordinojmë prioritetet, pra në cilat fusha dhe i informojmë gjatë gjithë kohës për mënyrën se si duhet të aplikojnë, që të rezultojnë të suksesshëm. Në programet e shumta trans-nacionale ne kemi çdo vit një numër në rritje të interesit në raport me të gjitha vendet e rajonit. Ka një tregues pozitiv që ka ardhur gjithmonë në rritje në përqindje. Pastaj interesi është në nivele më të larta, se sa të aftë jemi ne për të përthithur, por kjo varet edhe nga kapacitetet e aplikuesve.

Sigurisht, ne kontribuojmë nëpërmjet informimit dhe dhënies së asistencës për çdo gjë ata kanë nevojë. Ato janë programe që janë negociuar tashmë. Ne nuk jemi në fazën, ku mund të negociojmë për të ndryshuar prioritetet. Prandaj, thashë se ne do t'i kemi në konsideratë këto propozime në qasjen e re IPA III.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ky ishte qëllimi.

Besoj se jemi të qartë të gjithë për detyrimet tona dhe për detyrimet që kanë institucionet qendrore.

Atëherë, mund të kalojmë në votimin e marrëveshjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendova se e ezauruam.

Urdhëroni!

Xhemal Qefalia – Më falni, zonja kryetare!

Nuk dua të bëj diskutim, por lidhur me pyetjen që bëra, desha të sqaroj panelin aty, që nuk ishte shumë e vështirë për të gjetur shifrat, pasi projekti dhe marrëveshja është aty dhe ju e keni mbi tryezë, por meqenëse ju keni parë vetëm pjesën e parë, relatimin dhe nuk e keni parë marrëveshjen, po ua them unë qytetarëve shqiptarë. Ne duhet ta votojmë këtë marrëveshje, pasi Shqipëria përfiton 6225 kilometra nga 11 mijë kilometra që ka programi, ndërsa Mali i Zi përfiton 5745 kilometra. Edhe shifrën për popullsinë, mund ta gjenit, por nuk na e thatë...

Danjela Cekani – I kemi, por unë nuk i memorizoj dot, sepse ne kemi shumë programe të tilla. Unë sigurisht, do t'jua bëj të ditura menjëherë. Gjithsesi, këto shërbejnë në terma programimi. Tani, se sa do të përfitojnë realisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhemal Qefalia – Pala shqiptare përfiton, për sa i përket numrit të popullsisë, përfiton në 369 891 banorë, ndërsa pala malazeze përfiton në 379 361 banorë.

Ermonela Felaj – Faleminderit kolegë!

Atëherë, kalojmë në votimin e marrëveshjes!

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Kush është pro në parim?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2. Kush është dakord me këtë nen?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit!

Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj?

Kush është pro? Kush është kundër? 2 vota kundër.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Falënderoj zëvendësministrin dhe drejtoreshën për pjesëmarrjen!

Punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hanin e Hotit do ta kemi në monitorim dhe shpresoj, që ju të vini.

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretar
Pjerin Ndreu**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit
Antonela Veshi**